

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komiteti për Politikë dhe Financa;
Numër: 02-02/22;
Datë: 15.03.2022.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:


FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;
Lënda: mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Vendi: zyra e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 21.03.2022, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;
3. Lista e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
4. Nxjerrja e vendimit për bashkëpunim nderkomunal;
5. Të ndryshme



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02-01/22
Datë: 18.02. 2022, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Parë të Rregullt (2022) të Komitetit për Politike dhe Financa në Junik, të mbajtur më datë 18 Shkurt, 2022, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin të gjithë anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
3. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK),
4. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK), dhe
5. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV).

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe Kryetari i Komunës Ruzhdi Shehu, Nënkryetari Besart Tofaj, drejtoresha për Administratë të Përgjithshme Leonora Shehu, drejtoresha për Buxhet dhe Financa Vjollca Qestaj, drejtoresha për Ekonomi dhe Zhvillim Gentiana Tofaj, drejtori për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis Zenun Shala, drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Fatos Shala, drejtori për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport Xhavit Velijaj, dhe drejtori për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim Demokrat Ganiqaj, zyrtari Kryesor Financiar Arten Hamza, si dhe zyrtari për Marrëdhënie me Publikun Arton Gaxherri.

Mbledhjen e Parë të Rregullt (2022) të Komitetit për Politike dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, i cili përshëndeti të pranishmit në këtë mbledhje.

Kryesuesi, z. Shpejtim Gacaferi lexoi Rendin e Ditës dhe propozimet për pikat shtesë të Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Formimi i Grupit të Punës për hartimin e Projekt-Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022,
2. Raporti i buxhetit për vitin 2021 (nuk votohet në Kuvend),
3. Ri-shikimi i propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete,
4. Informatë rreth gjendjes së tanishme me Pandeminë Covid-19
5. Shqyrtimi i Vendimit të datës 04/03/2021 për subvencionimin e qytetarëve/banorë rezidentë të Junikut, të prekur nga Covid-19, dhe
6. Të ndryshme.

Në vazhdim kryesuesi tha, për **pikën e parë** si rregull është dashtë ta kemi Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2022 nga legjislatura e kaluar, mirëpo këtë nuk e kemi gjetur të gatshëm. Prandaj, na duhet ta formojmë një grup punues, në mënyrë që ta përgatisim Planin e Punës për këtë vit.

Të raporti i buxhetit për vitin 2021, është raport që është shpenzuar nga qeverisja e kaluar, por sipas rregullave duhet të raportohet edhe për buxhetin e vitit të kaluar.

Të **pika e tretë**, edhe kjo është si pikë e shtuar. Ne e kemi themeluar këtë Komitet, ia kemi dërguar Vendimin Ministrisë, sepse ashtu jemi të obliguar, mirëpo kemi hasur në disa shkelje dhe Vendimi është refuzuar.

Kryesuesi kërkoj miratimin e këtij Rendi të Ditës me këto ndryshime, dhe me pesë vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim ky Rend Dite miratohet për shqyrtim.

Pika e Parë, *Formimi i Grupit të Punës për hartimin e Projekt-Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2022*, z. Shpejtim Gacaferi tha, pra në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 22, paragrafi 3, thotë që nën udhëheqjen e kryesuesit, Kuvendi i Komunës themelon Grupin e Punës për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës. Unë përpos kryesuesit që duhet të jetë në këtë grup, unë propozoj që të jetë edhe një anëtar nga Ekzekutivi dhe tre të tjerë nga Kuvendi. Qëllimi është që sot të dakordohemi në “çelësin” dhe në numrin, ndërsa emrat i nxjerrim në Kuvend.

Tani këtë propozim e hedhim në votim vetëm si “çelës” në përbërje të pesë anëtarëve. Ky propozim kalon me pesë vota pro, pra më të gjitha votat. Pra, kryesuesi shkon me automatizëm, një anëtar është nga ekzekutivi, ndërsa tre të tjerët nga secili subjekt politik i Kuvendit.

Pika e Dytë, *Raporti i buxhetit për vitin 2021*, fjalën e mori zyrtari kryesor financiar z. Arten Hamza, për anëtarët e KPF-së paraqiti Raportin e Buxhetit Komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2021 dhe tha, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e organizatave buxhetore, në këtë rast ekzekutivi i Komunës së Junikut ka për obligim që në baza tre mujore të raportoj për buxhetin, pra për ecurinë e buxhetit të Komunës, dhe kjo është informata e katërt, pra e fundit, dhe ky është edhe raporti përmbledhës vjetor për vitin 2021.

Z. Arten Hamza tha, unë në pika të shkurta do t'i elaboroj ecuritë e këtij raporti, i cili përfshinë katërmëdhjetë programe buxhetore që janë në planifikim të buxhetit të Komunës së Junikut.

Në këtë raport prezantohen të hyrat dhe shpenzimet në baza vjetore, si dhe krahasimi i tyre në tri vitet e kaluara paraprake, duke i ndarë të hyrat dhe shpenzimet në të gjitha kategoritë.

Në vazhdim z. Arten Hamza shpjegoi tabelat e shpenzimit të buxhetit për vitin 2021, si dhe buxhetin e pashpenzuar të të hyrave vetanake të vitit 2020, të mbartura në vitin 2021. Sa i përket të hyrave, Komuna përpos grantit qeveritar ka pasur të hyra vetanake dhe mjete të mbartura, dhe donacione të cilat janë të shpjeguara në tabelat dhe grafikët e këtij raporti.

Pika e Tretë, *Ri-shikimi i propozimit për themelimin e Komitetit për Komunitete*, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, ne e kemi formuar këtë Komitet konform rregullave në Kuvend, mirëpo sipas Ministrisë ne kemi bërë shkelje në procedurë. Ne ua kemi dërguar Vendimin ashtu siç duhet; me emra, me datë, dhe të protokolluar, dhe në afatin e kërkuar ligjorë brenda shtatë ditësh, mirëpo pardje pasdite kemi pranuar një shkresë-refuzim nga ana e MAPL-së pasi që ata e kanë shqyrtuar përbërjen e Komitetit, i cili si i tillë nuk kalon. Prandaj, ata na i kanë dërguar edhe shpjegimet dhe arsyeshmerinë e refuzimit.

Këtë shkresë kryesuesi e lexoi për anëtarët e KPF-së, e cila sqaron se në komunat ku nuk ka komunitete, Komiteti mund të përbëhet nga përfaqësues të shoqërisë civile-komiteti i biznesit.

Pra, ne në fakt e kemi dorëzuar vendimin me përbërje të emrave, mirëpo MAPL-ja ka monitoruar seancën e Kuvendit të mbajtur me datën 22 Janar 2022, ku në **pikën e dytë** të Rendit të Ditës vetëm dy subjekte politike kanë marrë pjesë. Pra, LDK dhe LVV kanë jap propozimet e tyre për përbërjen e Komitetit për Komunitete, ndërsa AAK nuk ka pasur propozime. Dy anëtarë të tjerë të Kuvendit të Komunal janë propozuar nga komunitetet fetare, por jo edhe emrat e tyre.

Prandaj, për t'u vlerësuar ligjshmëria e këtij Vendimi nga MAPL, ky Komitet duhet të plotësohet me emrat e subjekteve politike që përfaqësohen në Komitetin për Komunitete, si dhe emrat nga shoqëria civile-komiteti i biznesit, dhe si i tillë të votohet në Kuvend. Prandaj, kjo duhet të plotësohet konform rregulloreve të kërkuara nga MAPL, dhe kjo duhet të shkoj si pikë e Rendit të Ditës në Kuvend, dhe në afatin ligjorë brenda 30 ditëve duhet të formohet ky Komitet.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, është mirë që të sqarohet, sepse problemi i 'çelësit' është bërë dhe është votuar, mirëpo problemi i përfaqësimit që janë dërguar emrat, por të cilët emra nuk kanë qenë konkret, prandaj ka pasur një keqkuptim. Prandaj, kjo pjesë do të merret nga shoqëria civile-komuniteti i biznesit, ndërsa partitë politike kanë nga një anëtar, dhe iu kisha lutur që ta arrijmë 50%-shin e kuotës për barazi gjinore, sepse grantin e performancës me shumë të gjetura e kemi humbur në vitin 2021, dhe kjo do të jetë pjesë e matjes së performancës që është në interes të qytetarëve dhe zyrtarëve të Komunës së Junikut. Prandaj, i lusë partitë politike që të kenë në konsideratë formimin e këtij Komiteti, veçse ne nuk kemi komunitet të pakicave, dhe në kuadër të kësaj të respektojmë edhe legjislacionin në fuqi për barazi gjinore. Prandaj, kjo është refuzuar me të drejtë nga MAPL-ja.

Pika e katërt, *Informatë rreth gjendjes së tanishme me Pandeminë Covid-19*, fjalën e mori drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale z. Fatos Shala i cili tha, drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Junik ka përpiluar një informatë rreth gjendjes së tanishme me pandeminë Covid-19. Kemi mbledh informacione së bashku me drejtorin e QKMF-së z. Ali Kuqi dhe stafin e QKMF-së, si dhe zyrën e inspektoratit këtu, në mënyrë që këto shifra të jenë sa më të sakta.

Qëllimi ynë ka qenë që të kemi informacione sa më të sakta dhe një gjendje sa më të saktë të pasqyruar. Kjo gjendje ka qenë para dhjetë ditëve, ndërsa pak më herët sot kam biseduar edhe zyrën e inspektoratit dhe gjendja momentale është; 154 të infektuar, aktive janë 5-7 persona. Situata është stabile, të hospitalizuar nuk kemi, dhe sipas drejtorit të spitalit, kostoja e trajtimit të virusit të variantit Omikron ka qenë shumë e ulët dhe e përballueshme për shumicën e qytetarëve, pra afërsisht diku rreth 30 Euro për trajtim të një individi.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, dje kemi pasur vetëm një rast pozitiv, kjo duke iu falënderuar vaksinimit me dozën e parë, të dytë dhe të tretë të qytetarëve është arritur shkalla e vaksinimit. Intensiteti i vaksinimit ka qenë më i vogël, por përhapja e këtij varianti ka qenë shumë e shpejtë sipas OBSH-së, mirëpo indikacionet i ka pasur shumë të lehta. Nuk kemi pasur raste të rënda, të hospitalizuar apo raste të vdekjeve në Junik në këtë kohë, krahasuar me statistikën në nivel vendi, për shkak të sëmundjeve të ndryshme kronike dhe moshave të shtyra.

Unë dua të shfrytëzoj rastin dhe të apeloj për njerëzit brenda kësaj administrate që të kujdesen dhe të vaksinohen në mënyrë që të mos kemi të pa vaksinuar, dhe të kemi një bashkëpunim me drejtorin e QKMF-së dhe drejtorin e Arsimit, që të ndikojmë të shtresa rinore në mënyrë që procesi i vaksinimit të bëhet sa më shumë. Kjo do të na ndihmojë në mbrojtjen e shëndetit publik.

Pika pestë, *Shqyrtimi i Vendimit të datës 04/03/2021 për subvencionimin e qytetarëve/banorë rezidentë të Junikut, të prekur nga Covid-19*, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, Kuvendi më datë 04/03/2021, ka nxjerrë një Vendim për subvencionim të qytetarëve banorë rezidentë të Junikut, të prekur nga Covid-19, për të mbështetur me

mjete financiare, të cilët janë subvencionuar me nga 100.00 Euro për person, ndërsa familjet e viktimave nga Covid-19 me nga 400.00 Euro.

Buxhetin e kësaj kategorie e shpjegoi z. Arten Hamza, dhe na tregoi edhe shumën se sa kanë mbetur për këtë kategori, dhe ne nuk mundemi të iu ikim atyre obligimeve të cilat duhet të kryhen kur kemi mundësi më të favorshme. Mirëpo, ne po diskutojmë pasi që gjendja pandemike në Junik tani nuk është aq ekstreme, dhe siç e tha edhe drejtori i Shëndetësisë, mesatarja e shërimit apo trajtimit është diku rreth 30.00 Euro për person. Ne po e shqyrtojmë këtë vendim që në të ardhmen mos ta ngarkojmë buxhetin e Komunës, duke krijuar obligime të cilat nuk mundemi t'i përballojmë.

Z. Xhemë Tofaj tha, kjo ka qenë për vitin 2021, kur ka qenë një kohë e vështirë, mirëpo tani këto shpenzime janë shumë më të ulëta, dhe unë jam që ky Vendim të shfuqizohet.

Z. Dervish Bajraktari tha, unë nuk e shoh të arsyeshme, sepse ka raste kur e tërë familja është e prekur nga virusi dhe shpenzimet janë më të mëdha, prandaj unë e shoh të arsyeshme që ky Vendim të vazhdojë edhe në vitin 2022.

Znj. Rajmonda Krasniqi tha, edhe unë pajtohem me mendimin e Dervishit që ky Vendim të mos shfuqizohet tani, pikërisht për të njëjtat arsye.

Z. Arten Hamza tha, normal që kjo i mbetet Kuvendit që të vendos mirëpo unë desha që të sqaroj se obligimet e subvencioneve janë obligime rreth 35,000.00 Euro, dhe nëse i zbresim ato 33,000.00 nga 50,000.00 të planifikuara për këtë vit, atëherë na mbesin diku më pak se 20,000.00 Euro në kategorinë e subvencioneve. Dihet se në Junik ka raste të ndryshme sociale që kërkojnë ndihmë shëndetësore të cilëve në raste të caktuara jemi të obliguar që t'u ndihmojmë, kryesisht në sektorin e shëndetësisë, siç janë raste me dializë apo sëmundje tjera, dhe nëse nuk shfuqizohet ky Vendim, ne nuk mundemi t'i përballojmë shpenzimet që na rrjedhin nga ky Vendim. Por nëse e marrim shumën financiare, numri i të infektuarve që mund të jetë ndoshta edhe më i madh, është problem që të mbulohet me mjete financiare, duke i marrë për bazë mjetet dhe obligimet që i kemi nga viti i kaluar. Prandaj, ta kemi parasysh edhe këtë, sepse vetëm këtë muaj kemi 154 raste të infektimeve, prandaj është vështirë që të mbulohen këto shpenzime me këtë buxhet që kemi.

Unë jam për atë që nëse paraqitet ndonjë rast social në kushte të rënda ekonomike, apo në raste të veçanta të vdekjes, mund të bëhet kërkesë për ndihmë në Komunë, mirëpo, nëse Vendimi mbetet në fuqi këto obligime duhet të kryhen për të gjithë. Pra, Vendimi është i juaji, mirëpo ta keni parasysh buxhetin e kufizuar që e kemi.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, ne kemi obligime edhe për studentët të cilat obligime nuk janë të kryera, të cilat duhet të kryhen me buxhetin e tanishëm, dhe tjetër, rastet pandemike apo shëndetësore të tjera që kanë nevojë për një Vendim, por Vendimi na ngarkon për vitin 2020-2021.

Tani kemi obligime tjera për mallra dhe shërbime të pambuluara që kanë për ta penguar procedimin e Komunës, siç është kontrata me Caritas-in, që është shumë e dëmshme, mirëpo ne kemi marrë obligime që deri në fund të vitit t'i paguajmë me këtë buxhet që kemi. Mirëpo, të kuptojmë si sqarim që gjendja pandemike në Komunën e Junikut është e lehtësuar tani.

Z. Shpejtim Gacaferi tha, qëllimi është ruajtja e buxhetit të Komunës, sepse momentalisht nuk e kemi luksin që ta mbulojmë atë shumë, dhe paskemi për obligim një shumë të konsiderueshme nga viti i kaluar për këtë kategori.

Unë, propozoj që ky Vendim si i tillë të anulohet, por nëse në të ardhmen Covid-i merr përmasa më të mëdha, ne prapë jemi këtu dhe mund të marrim vendime tjera.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, unë propozoj që të formojmë një komision të Kuvendit, që të analizohet gjendja nga profesionistë. Ky komision të përbëhet si në vijim; një anëtar nga Kuvendi, një nga Ekzekutivi, dhe një nga Shëndetësia, dhe të marrim rekomandimin e komisionit për këtë çështje, dhe të kthehemi në normalitet edhe ne sikurse komunat tjera, sepse kemi shumë obligime dhe një buxhet shumë të kufizuar për mallra dhe shërbime.


Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, pas shpjegimeve nga Kryetari unë e tërheq propozimin tim lidhur me këtë çështje.

Anëtarët e KPF-së u pajtuan me **propozimin** e Kryetarit si në vijim; si 'çelës' ky komision të përbëhet nga pesë anëtarë; dy nga Kuvendi, dy nga Ekzekutivi, dhe një nga Shëndetësia, i cili komision si qëllim ka vlerësimin e gjendjes pandemike Covid-19, dhe shqyrtimi për financim apo jofinancim të rasteve që mund të paraqiten në të ardhmen.

Ky propozim u miratua nga anëtarët e KPF-së me pesë vota pro, asnjë kundër, dhe asnjë abstenim.

Pika gjashtë, Të ndryshme, nuk pati diskutime

Me kaq, kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së.


Procesmbajtës,

Z. Shpejtim Gacaferi-Kryesues



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

01/Nr. Post: 2-155/1929
Një. Org: 3
Nr. i faq: 11/03/2022
Data: 11/03/2022



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	10.03.2022
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2021, Sipas këtyre programeve

E hyra vetanake për vitin 2021 sipas planifikimit dhe realizimit

Tabela e planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi vjetor 2021	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	8,449.00	18,736.40	10,287.40
2	Te hyrat nga urbanizmi	14,000.00	500.00	-13,500.00
3	Te hyrat nga administrata	6,900.00	6,288.00	- 612.00
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	6,000.00	4,772.00	-1,228.00
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	69,553.00	89,598.59	20,045.59
6	Regjistrimi i Automjeteve	5,900.00	7,194.00	1,294.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,000.00	7,387.00	1,387.00
8	Të hyrat tjera	6,000.00	9,943.50	3,943.50
	TOTALI	122,802.00	144,419.49	21,617.49

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2021 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **144,419.49€**. Shuma e planifikuar për vitin 2021 është **122,802.00€**, ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2021 në vlerë prej **21,617.49€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjybat në trafik në shumë prej 4,798.50€.

Në mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **21,617.49€**, totali i të hyrave për vitin 2021 të rritet nga 122,802.00€ në 144,419.49€.


Kjo rritje në vlerë prej **21,617.49€**, të bartet si në vijim:

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit 46030 – 3,966.39€.
- Nën programi 18020 Shërbime publike – infrastruktura rrugore në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq me kod të projektit 51315 – 10,651.10€.
- Nën programi 74200 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 7,000.00€.

Ju faleminderojmë për mirëkuptim!



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-155/1928
Një. Org. 2
Nr. i faq. 1
Data 11/03/2022



REPUBLICA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	10.03.2022
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2021 në vitin 2022



Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2021 në vitin 2022.

Në vitin 2021 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej **122,802.00€**, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2021 duke përfshirë edhe të hyrat nga gjërat në trafik është **144,419.49€**. Të hyrat e bartura nga viti 2020 në vitin 2021 janë në vlerë prej **31,830.15€** ku gjithsej të hyra në vitin 2021 janë **176,249.64 €**. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2021 janë shpenzuar gjithsej **84,333.65€**.

Shuma e mbetur për bartje është **91,915.99 €** ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

- Shuma prej **56,953.40€** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 51315 “**Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq**”, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.
- Shuma prej **10,000.00€** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 47283 “**Ndërtimi i kanaleve të ujitjes**”, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020
- Shuma prej **9,012.59 €** të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 “**Bashkëfinancimi i projekteve**”, në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- Shuma prej **8,950.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike subvencione, në Programin Zyra e Kryetarit me kod 160, në nën Programin Zyra e Kryetarit me kod 16020.
- Shuma prej **7,000.00 €** të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Shëndetësia dhe Mirëqenia sociale me kod 730, në nën Programin Shërbimet e shëndetësisë primare me kod 74200.

Në total të hyra për bartje nga viti 2021 në vitin 2022 janë **91,915.99 €**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	10.03.2022
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i obligimeve Kontraktuale për vitin 2021

Te nderuar

Sipas kërkesës së deputetëve të kuvendit komunal në seancën e fundit të prezantimit të raportit të buxhetit për vitin 2021 është kërkuar të prezantohet një raport i vocante lidhur me obligimet Kontraktuale për vitin 2021

Me përfundimin e vitit 2021, janë përgatitur raporti vjetor financiar për vitin 2021 i cili është prezantuar dhe raportuar në kuvendin komunal në seancën e mbajtur më 28.02.2022 si dhe Pasqyrat financiare vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 të cilat janë dërguar në Ministrinë e Financave sipas afateve të përcaktuara ligjore, në të cilat janë të përfshira të gjitha të dhënat për të hyrat dhe shpenzimet si dhe Llogaritë e arkëtueshme dhe Llogaritë e pagueshme si dhe të gjitha shpalosjet tjera të nevojshme sipas standardeve dhe udhëzimeve për përgatitjen e pasqyrave Financiare.

Sa i përket obligimeve të papaguara të vitit 2021 ju njoftoj se në bazë të faturave të pranuar përmes protokollit të Komunës janë gjithsejtë 105,532.54€ sipas këtyre Kategorive ekonomike:

Mallra dhe Shërbime –	98,245.49
Shpenzime Komunale –	3,493.30
Investime Kapitale -	3,793.75
Totali	105,532.54

Në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve si obligime më të theksuara janë : 70,407.00€ obligime ndaj Caritasit bazuar në kontratën për Ofrimin e shërbimeve administrative, shëndetësorë, edukative, kulturore. 11,719.20€ derivate për vetura, ngrohje dhe gjenerator. 2,632.62€ shpenzime të telefonisë mobile. 1,284.67€ Shërbime të printimit, 1,158.76€ Mirëmbajtje dhe servisim i automjeteve, 5,764.80€ Transport i nxënësve, 978.80€ Reklama dhe shërbime postare. 458.00€ furnizim për zyre etj.

Në kategorinë e Shpenzimeve Komunale janë: 3,280.70€ shpenzime të rrymës, 126.91€ shpenzime të ujit, 85.69€ shpenzime të telefonisë fikse

Në investime kapitale është një fature 3,793.75 nga Projekti Hapja e rrugëve fushore .

Të gjitha këto që u ceken më lartë janë obligime të faturuara për të cilat i kemi pranuar faturat mirëpo në mungesë të mjeteve kanë mbetur obligime.

Përpos obligimeve të faturuara kemi edhe obligime tjera të kontraktuara sipas kontratave të nënshkruara dhe sipas vendimeve të ndryshme.

Në kategorinë e Subvencioneve sipas raporteve të komisioneve të caktuara dhe sipas vendimeve përkatëse kemi obligime gjithsejtë 33,150.00€ nga këto, 7,400.00€ janë obligime për personat e infektuar me COVID 19 dhe 25,750.00 janë obligime për subvencionimin e studentëve.

Obligime kontraktuale në bazë të kontratave të nënshkruara i kemi :

Ne kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

1. Transporti i nxënësve në relacionin Lagjja Agim Ramadani – shkollë” dhe anasjelltas, afati i mbetur i kontratës 17 muaj, vlera e mbetur 23,328.00€
2. Furnizimi me material Hixhienik, afati i mbetur i kontratës 4 muaj, vlera e mbetur 1,349.90€
3. Ofrimi i shërbimeve administrative profesionale, edukative, kulturore dhe psikosociale, afati i mbetur i kontratës 5 muaj, vlera e mbetur 103,754.79€
4. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore sociale për personat në nevojë në Komunën e Junikut, afati i mbetur i kontratës 5 muaj, vlera e mbetur 58,285.60€

Ne kategorinë e investimeve Kapitale .

1. Asfaltimi i rrugëve lokale, afati i mbetur i kontratës 7 muaj, vlera e mbetur 18,090.45€
2. Rehabilitimi i rrugëve lokale, afati i mbetur i kontratës 7 muaj, vlera e mbetur 14,991.00€
3. Ndërtimi i qendrës për kulturë, turizëm dhe agrobiznes, afati i mbetur i kontratës 10 muaj, vlera e mbetur 339,096.04€
4. Rregullimi i Shtratit të Lumit Erenik – Junik, ka përfunduar afati i kontratës, vlera e mbetur 160,260.60€
5. Hartimi i Hartës Zonale dhe Planit Zhvillimor Komunal, ka përfunduar afati i kontratës, vlera e mbetur 9,750.00€
6. Ndërtimi i rrugës Junik – Gjeravicë, afati i mbetur i kontratës 22 muaj, Vlera e kontratës së nënshkruar 4,416,859.77€
7. Memoriali i Dëshmorëve të UÇK- së, Junik, ka përfunduar afati i kontratës, vlera e mbetur 18,360.00€
8. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Agim Ramadani- Junik, ka përfunduar afati i kontratës, Vlera e kontratës së nënshkruar 86,036.20€
9. Ndërtimi i parkut të lojërave për fëmijë, ka përfunduar afati i kontratës, vlera e mbetur 4,314.00€
10. Asfaltimi i rrugës lokale Junik-Jasiq, afati i mbetur i kontratës 9 muaj, vlera e mbetur 111,953.40€

Sa i përket obligimeve kontraktuale mund të ketë edhe obligime tjera nga kontratat e nënshkruara para dy apo tre viteve për të cilat ne si Drejtori për buxhet dhe financa nuk disponojmë me shënime dhe njohuri.

Bashkangjitur i keni tabelën e raportit të obligimeve kontraktuale .

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Organizata Buxhetore: Komuna Junik
Kodi Buxhetor: 636



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna Junik - Opština Junik - Municipality Junik

Numri i projektit në Ligjin e buxhetit	Numri i zotimit në SIMFK	Titulli i kontratës (i plotë)	Numri i prokurimit (e-prokurim)	Vlera gjithsej e kontratës	Afati i kontratës (në muaj)	Vlera e mbetur e kontratës	Afati i mbetur i kontratës (në muaj)	Shënime
88352		Hapja e rugeve fushore - Faza III - të	636-20-1695-5-2-1	33,793.75	12 muaj	3,793.75	Perfunduar	Kapitale
130		Transporti i nxënësve në relacionin, lagjia " Agim Ramadani "	636-20-1189-2-2-1	35,769.60	36 muaj	23,328.00	17 muaj	Malra dhe sherbime
45605		shkollë dhe anasjelltas	636-20-2198-5-2-1	79,920.60	24 muaj	18,090.45	7 muaj	Kapitale
46031		Asfaltimi i rrugëve lokale	636-20-2622-5-2-1	49,990.00	24 muaj	14,991.00	7 muaj	Kapitale
		Rehabilitimi i rrugëve lokale						
		Marrja në shfrytëzim e paisjeve për spërkatje të duarve me dezinfektant	636-20-5921-2-3-6	3,240.00	12 muaj	270.00	Perfunduar	Malra dhe sherbime
130		Transporti i nxënësve Junik (shkollë e mesme) - Ponošec dhe anasjelltas	636-20-5937-2-2-1	11,040.00	12 muaj	3,180.00	Perfunduar	Malra dhe sherbime
130		Ndërtimi i qendrës për kulturë, turizëm dhe agrobiznes	636-19-5776-5-1-1	777,777.77	36 muaj	339,096.04	10 muaj	Kapitale (Bashkëfinancim)
46030		Rregullimi i Shtratit të Lumit Erenik - Junik	636-19-5553-5-2-1	260,260.60	24 muaj	160,260.60	Perfunduar	Kapitale (Ministria e mjedist dhe Planifikimit)
46030		Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve	636-19-7900-2-2-1	26,997.22	12 muaj	6,561.60	Perfunduar	Malra dhe sherbime
130		Hartimi i Hartës Zonale dhe Plani Zhvillimor Komunal	636-19-3457-2-2-3	34,750.00	24 muaj	9,750.00	Perfunduar	Kapitale- Bashkëfinancim
46030		Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë	636-19-5225-5-1-1	4,416,859.77	36 muaj	0.00	22 muaj	Kapitale (Ministria e Infrastruktues)
13706		Ofrimi i sherbimeve administrative profesionale, edukative, kulturore dhe psikosociale	636-21-1973-3-2-1	147,168.00	12 muaj	103,754.79	5 muaj	Malra dhe sherbime
130		Ofrimi i sherbimeve shëndetësore sociale për personat në	636-21-1925-2-2-1	81,600.00	12 muaj	58,285.60	5 muaj	Malra dhe sherbime
18281		Memoriali i Dëshmorëve të UÇK- së, Junik	636-21-2501-5-2-1	48,360.00	3 muaj	18,360.00	Perfunduar	Kapitale- Bashkëfinancim
		Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Agim Ramadani- Junik	636-21-1366-5-2-1	86,036.20	5 muaj	6,036.20	2 muaj	Kapitale- Bashkëfinancim
46030		Ndërtimi i parkut të lojërave për fëmijë	636-21-3597-5-2-1	14,314.00	2 muaj	4,314.00	Perfunduar	Kapitale- Bashkëfinancim
46030		Furnizimi me material Hixhienik	636-21-3661-1-3-6	1,849.30	6 muaj	1,349.90	4 muaj	Malra dhe sherbime
130		Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit të rrjetit publik	636-21-7188-5-2-1	26,620.00	1 muaj	-	Perfunduar	Kapitale- Bashkëfinancim
46030		Asfaltimi i rrugës lokale Junik-Iasiq	636-21-6898-5-2-1	145,651.10	2 muaj	111,953.40	1 muaj	Kapitale
51315		Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	636-21-6803-5-3-6	9,612.20	1 muaj	-	Perfunduar	Kapitale
47283				6,102,553.06		883,375.33		
Gjithsej								

Shënim: Kontratat e AQP-së duhet të prezantohen vetëm për pjesën e OB-së (Kërkesa e dërguar nga OB-ja për prokurim nga AQP).

Zyrtari Kryesor Financiar
Arten Hamza

Zyrtari Kryesor Administrativ
Ruzhdi Shetu

Vendi, Data, Junik, 17.01.2022

Vendi, Data, Junik, 17.01.2022